



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**KËSHILLI I BASHKISË**  
**KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK**

Nr. 3918/Prot.

Patos, më 11/12/2024

**PROCESVERBALI I TAKIMIT 10 DHJETOR 2024**

**Vendi:** "Salla e Këshillit Bashkiak Patos"

**Ora e fillimit:** 10:00

**Ora e mbarimit:** 11:00

**Dëgjuesë publike me temë:** "Strategjia Vendore e Zvogëlimit të Riskut nga 2024-2030".

**Baza Ligjore:** Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si edhe vendimi nr. 94, datë 22.02.2023 "Për miratimin e Strategjisë së Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Planit të Veprimit".

**Pjesëmarrës:** Zv/kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli, Sekretare e Këshillit znj. Rafaela Xeba, Përgjegjës i sektorit të Emergjencave Civile z. Arben Shpërdheja, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, rreth 41 pjesëmarrës (administratorë të njësive administrative, përfaqësues të shoqërisë civile, kryetarë të fshatrave, përfaqësues të prefekturës, grupe interesi etj)

**Takimin hapet nga sekretare e Këshillit znj. Rafaela Xeba**

**Sekretare e Këshillit znj. Rafaela Xeba-** të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik, sot do të prezantojmë dokumentin mbi Strategjinë Vendore të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030. Ftoj ekzekutivim për paraqitjen e materialit dhe në rast së do të keni ndonjë pyetje apo diskutim jeni të lutur ta paraqisni në fund sipas rregullave të dëgjesave publike.



**Sekretare e Këshillit  
znj. Rafaela Xeba**

**Dëgjese publike me temë:**

**“Strategjia Vendore e Zvogëlimit të  
Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.**

**Dhjetor 2024**

**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos znj. Ina Sauli-** përshëndetje! Unë ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe le të fillojmë me prezantimin e strategjisë. Kërkoj bashkëpunim nga ana juaj edhe në paraqitjen e pyetjeve dhe sugjerimeve.



**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos  
znj. Ina Sauli**

**Dëgjese publike me temë:**

**“Strategjia Vendore e Zvogëlimit të  
Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.**

**Dhjetor 2024**

**Përgjegjës i sektorit të Emergjencave Civile z. Arben Shpërdheja-** përshëndetje! Unë ju falenderoj për pjesëmarrjen në këtë konsultim publik. Një falenderim për grupin e punës të bashkisë Patos, drejtorët e drejtorive, përgjegjësat e sektorëve me në krye zv/ kryetaren e bashkisë znj. Ina Sauli, grupin e punës Metropolis, grupin e punës UNDP, grupin e punës

AKMC dhe në veçanti kryetarët e fshatrave që kane sjellë gjithë informacionin e nevojshëm në hartimin e këtij dokumenti.

Bazuar në vendimin nr. 94, datë 22.02.2023 “Për miratimin e Strategjisë së Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Planit të Veprimit”, u vendos miratimi i Strategjisë 2023-2030.



**Përgjegjës i sektorit të Emergjencave  
Civile**

**z. Arben Shpërdheja**

**Dëgjësë publike me temë:**

**“Strategjia Vendore e Zvogëlimit të  
Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.**

**Dhjetor 2024**

Në hartimin e këtij dokumenti në bashkëpunim me gjithë grupet e punës u ezauruan të gjitha informacionet e nevojshme mbetjeve, zjarreve të pyjeve, rrëshkitjeve të tokave, ndotjeve dhe risqet biologjike që janë në territorin e bashkisë. U bë studimi i të gjithë zonave me risk të shtuar ndaj fatkeqësive. Janë zhvilluar takime me persona kyç dhe u plotësuan pyetësorët për të marrë të dhëna për hartimin e strategjisë. Grupi i punë i mbështetur nga kompania konsulente hartoi dokumentin e strategjisë bazuar në të dhënat e mbledhura dhe janë zhvilluar disa dëgjesa publike veçanërisht për konsultimin e planit të veprimit me qëllim sistemimin e pasaktësive të mundshme dhe finalizimin e dokumentit. Për të siguruar një qasje bashkëpunuese u zhvilluan takime ndërmjet kryetarëve të bashkive të qarkut Fier dhe prefektit. Synimi ishte integrimi i zvogëlimit të riskut ngqa fatkeqësitë në politikat dhe planet rajonale duke siguruar harmonizimin e strategjive vendore në objektivat më të gjera të qarkut. Dokumenti synon të zvogëloj risqet nga fatkeqësitë dhe do të shërbej si një udhërrëfyes kyç për planifikimin e zhvillimit urban duke marrë masa për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë. Kjo do të siguroj që planifikimi urban dhe zhvillimi i bashkisë të marrë në konsideratë risqet nayrore dhe mjedisore dhe duke rritur qendrueshmërinë. Ky dokument duhet të rishikohet dhe të ndryshohet nëse është e nevojshme vazhdimisht për tu përshtatur me ndryshime dhe sfiqat napa rreziqet e mundshme.

Grupi teknik vlerëson se ky dokument është i përfunduar dhe përfaqësin një dokument cilësor që i paraqitet bashkisë, ndaj edhe unë kërkoj edhe angazhimin tuaj sot në këtë dëgjësë publike duke ngritur diskutime apo sugjerime të ndryshme. Faleminderit!

**Përfaqësues i Co- Plan z. Ledio Allkja**- përshëndetje! Faleminderit Arbenit për prezantimin e materialit dhe besojn që ai i përmendi të gjithë elementet kryesor mbni bazën ligjore në të cilën është ndërtuar kjo strategji. Bashkia Patos ose 6 bashkitë e qarkut Fier janë ndër të parat që plotësojnë këtë dokument. Ky kuptohet që është një avantazh në momentin që aplikohet për fonde apo për të menaxhuar shumë mirë rrezikun e fatkeqësive për të ulur riskun. Strategjia ndërton mbi vlerësimin e riskut ashtu siç u përmend. Vizioni i strategjisë është që të jetë e aftë të përballoj risqet e fatkeqësive duke mbështetur kështu zhvillimin e saj të qëndrueshëm. Kjo strategji është e harmonizuar edhe me politikat kombëtare dhe kërkohet të



**Përfaqësues i Co- Plan  
z. Ledio Allkja**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Strategjia Vendore e Zvogëlimit të  
Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.**

**Dhjetor 2024**

trajnohet më mirë komuniteti në mënyrë që të bashkëpunohet në rast rreziku. Objektivat strategjik kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve strategjike dhe ky objektivi synon kryesisht të punohet brenda bashkisë për të rritur kapacitetet administrative, teknike, operacionale dhe forcimin e qëndrueshmërisë financiare. Objektivi tjetër lidhet me ndërgjegjësimin, edukimin dhe trajnimin e komunitetit dhe objektivi fundit lidhet me ndërhyrjet e drejtëpërdrejta në territor për të zvogëluar riskun. Objektivat lidhen me masa të ndryshme. Zvogëlimi i riskut nuk duhet parë si një detyrë sektoriale, por duhet parë më gjerë, pasi këtu mund të futen edhe projekte që lidhen me ndryshimet klimatike, ndryshimet në mjedis dhe aktualisht shumë prej organizmave ndërkombëtar me të cilët po operon Shqipëria kanë projekte dhe fokusohen në fushën e ndryshimeve klimatike. Element i rëndësishëm është edhe integrimi i zvogëlimit të riskut për sa i përket vullnetarëve apo zjarrfikëses që të parashikohen nga ana monetare apo pagesa. Për përf forcimin e kapaciteteve të stafit ne filluam që me ngritjen e bazës së të dhënave, përdorimi i GIS dhe në këtë rast UNDP është duke mbështetur bashkinë për të përdorur këtë komponent. Tjetër element është edhe rishikimi i planeve dhe nevojave për evakuim që mund të kenë shkolla, kopshtet, çerdhet etj. Krijimi i rezervave për emergjencat civile dhe mirëmbajtja e saj, ngritja e një qendre operacionale për emergjencat civile është një kërkesë ligjore dhe kjo është një pikë e cila do të mbështetet nga UNDP. Gjithashtu është edhe pajisja me mjete zyre apo transporti. Ne kemi parashikuar edhe disa projekte të tjerë në

nivel qarku si psh. organizimi i konferencave të donatorëve duke qenë se të 6 (gjashtë) bashkitë kanë strategjinë tashmë. Gjithashtu edhe lidhja e një marrëveshjeje midis bashkive për pyllin e Drenies dhe mbrojtjen e tij nga zjarri.

AKMC është duke punuar disa module trajnimi të cilat më pas do të merren dhe do të përshtaten nga vet bashkia. Tjetër element është edhe ndërgjegjësimi dhe edukimi i grupeve vulnerabël dhe sërisht janë parashikuar një sërë trajnimesh që prekin këto grupe. Fillimisht kërkohet konsolidimi i grupeve të vullnetarëve që do trajnohen, të cilët duhet të identifikohen dhe të ngrihet një database që do shërbej në mënyrë digjitale dhe të pëditësuar. Ndërhyrjet në territor që ndikojnë drejtpërdrejt duke filluar që nga hartimi i një protokollit për monitorimin e vazhdueshëm të kanaleve kulluese, vlerësimi teknik i digave dhe rezervuareve dhe aktualisht janë disa projekte që po punojnë me digat që janë jashtë funksionit. Është shtuar edhe një fond nga AKMC që është specifik për digat. Elementi i fundit lidhet me urat mbi të cilat duhet bërë një studim pasi janë infrastrukturë kritike për sa i përket edhe rrezikut që kanosin. Rrëshqitjet e tokës duhen studiuar dhe duhen monitoruar zonat me rrezik rrëshqitje, duhen marrë masa për stabilizimin e tyre bazuar në këto studime. Për sa i përket riskut nga zjarri, një nga elementët kryesor është hapja e korridoreve për të pasur akses sa më shpejt. Lidhur me riskun sizmik, bashkitë kanë detyrimin që të bëjnë studimin sizmik të ndërtesave mbi 50 vjet dhe duhet të fillohet me ato ndërtesa që kanë një numër më të shumtë të njerëzve. Për sa i përket ndryshimeve klimatike dhe aplikimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë, studimi për të mbjell pemë, studimi i ndryshimeve klimatike në përkeqësimin e situatës, vlerësimi i ndikimit të ishujve të nxhtësisë urbane në qytetin e Patosit dhe eksplorimi i zgjidhjeve të ndryshme dhe vlerësimi i riskut të thatësirave në kontekstin e ndryshimeve klimatike etj. Faleminderit!

**Përfaqësues nga prefektura e qarkut Fier z. Kreshnik Imeraj-** përshëndetje! Për sa i përket riskut teknologjik që është një risk i ekspozuar në bashkinë Patos kryesisht nga subjektet private duke marrë parasysh faktin që operon edhe Bankers, nuk e di nëse mundet të



**Përfaqësues nga prefektura e qarkut  
Fier**

**z. Kreshnik Imeraj**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Strategjia Vendore e Zvogëlimit të  
Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.**

**Dhjetor 2024**

ndikojë bashkia me norma ose me akte që këto masa të implementohen dhe të zbatohen nga kompania që operon në këtë zonë.

**Përfaqësues i Co- Plan z. Ledio Allkja-** është e vërtetë që kjo kompani private operon në këtë territor, por bashkia mund të bëjë monitorimin e impaktit që ajo ka në territorin e bashkisë psh. duke analizuar ndotjen e tokave bujqësore ose prezencën e metaleve të rënda që ndihen drejtëpërdrejtë nga kjo lloj industrie. Kuptohet që më pas shkalla e verpimit nuk varet vetëm nga bashkia, por duke pasur evidenca të qarta për impaktin në mjedis dhe veçanërisht në ujin e pijshëm mund ta ketë më të qartë për të ndërhyrë.



**Përfaqësues i Co- Plan  
z. Ledio Allkja**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Strategjia Vendore e Zvogëlimit të  
Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.**

**Dhjetor 2024**

**Përfaqësues nga prefektura e qarkut Fier z. Kreshnik Imeraj-** për sa i përket mbledhjes së donatorëve mendoj që duhet të jeni ju iniciuesit e kësaj mbledhjeje duke shfrytëzuar edhe eksperiencën që ju keni në këtë fushë duke organizuar mbledhje më donatorë në qarkun Fier. Sa mund të na ndihmoni dhe mund të jeni të gatshëm për të thërritur donatorët duke qenë se keni qenë ju hartuesit e këtij dokumenti. Kam edhe një pyetje për grupin e punës. Thatë që strategjia dhe të dhënat janë hedhur në GIS. A mund të kenë të gjithë akses në këtë sistem dhe mund të përdoret nga ne?



**Përfaqësues nga prefektura e qarkut  
Fier  
z. Kreshnik Imeraj**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Strategjia Vendore e Zvogëlimit të  
Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.**

**Dhjetor 2024**

**Përfaqësues i Co- Plan z. Ledio Allkja-** ne patjetër që do ju mbështesim edhe pse kjo është përtej detyrave tona në këtë projekt, por duke qenë se është një projekt që është ndërtuar bashkërisht me bashkitë e tjera patjetër që do ju mbështesim. Për sa i përket sistemit ato të dhëna që ne kemi patjetër që mund t'ua kalojmë dhe t'ju njohim.



**Përfaqësues i Co- Plan  
z. Ledio Allkja**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Strategjia Vendore e Zvogëlimit të  
Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.**

**Dhjetor 2024**

**Përfaqësues i Kryqit Kuq Patos znj. Drita Hyseni-** përshëndetje! Ju trajtuat një çështje shumë të rëndësishme, por për pjesën e trajnimit ju vetëm përmendët që duhen trajnuar, por



**Përfaqësues i Kryqit Kuq Patos  
znj. Drita Hyseni**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Strategjia Vendore e Zvogëlimit të  
Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.**

**Dhjetor 2024**

si? Duhet trajnuar me uniform, me të gjitha sepse Patosi nuk është trajnuar akoma. Duhet të kishit kapur një pikë lidhur me këtë temë.

**Përfaqësues i Co- Plan z. Ledio Allkja-** në dijenin time janë zhvilluar disa seanca trajnimi,



**Përfaqësues i Co- Plan  
z. Ledio Allkja**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Strategjia Vendore e Zvogëlimit të  
Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.**

**Dhjetor 2024**

madje edhe stimulimet në terren në verë janë zhvilluar për të trajnuar stafin e bashkisë, por është vet bashkia ajo që bën planin e trajnimeve sipas nevojave.

**Përgjegjës i Emergjencave Civile z. Arben Shpërdheja**- ne kemi bërë planin e trajnimeve për të gjithë punonjësit e kopshteve, çerdheve etj sepse janë punonjës me risk dhe do të filloj në muajin mars të vitit 2025.



**Përgjegjës i Emergjencave Civile  
z. Arben Shpërdheja**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Strategjia Vendore e Zvogëlimit të  
Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.**

**Dhjetor 2024**

**Zv/ kryetare e bashkisë Patos znj. Ina Sauli**- nëse nuk keni diçka tjetër ta mbyllim këtu këtë dëgjesë publike dhe ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe kohën tuaj.



**Zv/ kryetare e bashkisë Patos  
znj. Ina Sauli**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Strategjia Vendore e Zvogëlimit të  
Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.**

**Dhjetor 2024**

**Koordinator i Konsultimit Publik**

Simela Shahinaj

**Sekretar i Këshillit**

Refaela Xeba







